



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 36.**

**Prishtinë, më 9.03.2016 në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Slavko Simiq, Danush Ademi dhe.

**Munguan:**, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Veton Berisha dhe Qerim Bajrami.

**Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje :** Sanije Berisha- përfaqësuese e OSBE-së, Artan Murati përfaqësues i KDI-së, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz -Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 5.02.2016, 16.02.2016 dhe 19.02.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryesuesja,** konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbaleve në mbledhjet e mbajtura, më: 5.02.2016, 16.02.2016 dhe 19.02.2016;**

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 5.02.2016, 16.02.2016 dhe 19.02.2016, pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

**Kryesuesja**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

*Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**

**Kryesuesja**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-064 për Patentë Shofer, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

## **5. Të ndryshme.**

**Kryesuesja**- si çështje plotësuese sot do të diskutohet lidhur me dy propozime; sa i përket vizitë në Greqi, unë Jasmina Zhivković dhe Myfera Sinik, nuk kemi mundësi të udhëtojmë për arsye të angazhimeve parlamentare. Për udhëtimin në Greqi u propozuan: Slavko Simiq dhe Danush Ademi.

Si çështje e dytë është interesimi i Institutit Demokratik i Kosovës- KDI, që të ofrojë përkrahje Komisionit në fushën e hulumtimit legjislativ. Për detaje të hollësishme fjalën ia dha përfaqësuesit të KDI-së.

**Artan Murati**, KDI-ja është njëra nga organizatat kryesore e cila mbështetë punën e Komisioneve Parlamentare që nga viti 2006. KDI-ja në këtë periudhë ka ndërmarr një aksion dy vjeçar për të ofruar hulumtime profesionale për Komisionet Parlamentare. Qëllimi i projektit “Përkrahje për Hulumtime Parlamentare dhe Pjesëmarrja Qytetare” është të ngrit kualitetin e legjislacionit përmes hulumtimeve parlamentare. KDI-ja do të ofrojë të dhëna dhe alternativa për monitorimin e ligjeve, ka në disponim një numër të madh ekspertësh nga lëmi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve dhe nga ky aspekt mund t’i ofrojë ndihmë Komisionit në çdo kohë. Hulumtimet do të mund të jenë nga aspekti i praktikave ndërkombëtare të cilat janë praktikatat më të mira në regjion.

**Kryesuesja**, veçoi se në takim e radhës, Komisioni do të përcaktohet për çështjet e ngritura nga KDI-a dhe njëherit do të shqyrtojë çështjet që ndërlidhen me tre mujorin e parë të Planit të Punës për vitin 2016.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Jasmina Zhivković**